



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 12 dhjetor 2011
Nr. ref.: RK174/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 80/11

Parashtruesi

Lutfi Dervishi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë:

Kp. nr. 196/2009 i 8 qershorit 2009;

PPS. nr. 02/2009; P. nr. 309/10; P. nr. 340/10; KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 1 marsit 2011;

P. nr. 309/10; P. nr. 340/10; KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 27 prillit 2011.

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodriguez, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Cukalovic, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi

1. Parashtruesi është z. Lutfi Dervishi, i përfaqësuar nga z. Linn Slattengren, avokat nga Prishtina.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi konteston vendimet e mëposhtme të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë:
 - a. Kp. nr. 196/2009 i 8 qershorit 2009, që pretendohet se asnjëherë nuk i është dorëzuar parashtruesit;
 - b. PPS. nr. 02/2009, P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 1 marsit 2011, që pretendohet se janë pranuar nga përfaqësuesi i parashtruesit më 1 mars 2011; dhe
 - c. P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10, të 27 prillit 2011, që pretendohet se janë pranuar nga përfaqësuesi i parashtruesit më 27 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që të vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimeve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ku pretendohet se janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 [E drejta në gjykim të drejtë e të paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta në gjykim të drejtë] dhe neni 5 [E drejta në liri dhe siguri] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEMDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 9 qershor 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodriguez si Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Enver Hasani dhe Altay Suroy.
7. Më 15 shtator 2011, parashtruesi, duke informuar Gjykatën se “Gjykata e Qarkut të Prishtinës ka vendosur rastin për gjykim duke filluar nga 4 tetori 2011”, ka kërkuar informacion mbi “gjendjen e procedurave” dhe nëse Gjykata “pret që të marrë ndonjë veprim para datës së gjykimit”.
8. Më 19 shtator 2011, Gjykata informoi parashtruesin se rasti është regjistruar dhe po shqyrtohet nga Gjykata. Në të njëjtën datë, Gjykata ia komunikoi kërkesën Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
9. Më 11 tetor 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën Prokurorit të EULEX-it në Prishtinë.
10. Më 22 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 12 nëntor 2008, prokurori filloi hetimet kundër parashtruesit për shkelje penale të nenit 139.1 dhe 23 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPK), për një periudhë fillestare prej gjashtë muajsh.
12. Më 22 maj 2009, prokurori paraqiti një kërkesë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për të vazhduar hetimet për gjashtë muaj të tjerë.
13. Më 31 maj 2009, gjyqtari i procedurës paraprake të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë ka refuzuar kërkesën për të zgjatur hetimet edhe për gjashtë muaj të tjerë (GJPP 361/08). Arsyetoi se *“në rastin konkret, hetimet kanë filluar më 12 nëntor 2008, kështu që mandati fillestar i hetimeve prej 6 (gjashtë) muajsh ka skaduar më 12 maj 2009. Kërkesa e Prokurorit Publik për të vazhduar hetimet e mëtejshme edhe për 6 (gjashtë) muaj është paraqitur në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë më 22 maj 2009, me një vonesë prej 10 (dhjetë) ditësh. Kështu që hetimi, që tashmë i kishte kaluar afati në kohën kur kërkesa për zgjatje ishte paraqitur nga Prokurori Publik (më 22 maj 2009), nuk mund të vazhdojë edhe më tej”*, në pajtim me nenin 94, 95 dhe 225 të KPK.
14. Në qershor 2011, prokurori paraqiti një kërkesë kundër këtij vendimi në Kolegjin Ankimor të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
15. Më 8 qershor 2009, Kolegji Ankimor i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë miratoi ankesën e Prokurorit dhe iu pranua atij/asaj kërkesa për zgjatjen e hetimeve (Kp. nr. 196/2009), duke marrë parasysh se *“Neni 225 i KPK nuk thekson shprehimisht se kërkesa për zgjatjen e hetimeve duhet të paraqitet në vazhdimësi me zhvillimet e hetimeve të deriatëhershme”*. Kundër këtij vendimi, në pajtim me nenin 431 (2) të KPK, nuk lejohet ankesë.
16. Më 9 nëntor 2009, gjyqtari i procedurës paraprake miratoi një vazhdim tjetër për gjashtë muaj të tjerë.
17. Më 11 janar 2010, gjyqtari i procedurës paraprake miratoi edhe një vazhdim për gjashtë muaj të tjerë.
18. Më 12 maj 2010, Gjykata Supreme miratoi një vazhdim të jashtëzakonshëm të hetimeve për gjashtë muaj shtesë.
19. Më 15 tetor 2010, është paraqitur akuzë në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë (PPS. nr. 41/09).
20. Më 20 tetor 2010, akuza (PPS. nr. 107 /10) u paraqit në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.
21. Më 29 nëntor 2010, akuza e 15 tetorit 2010 u bashkua me atë të 20 tetorit 2010.
22. Më 14 dhjetor 2010 dhe 6 janar 2011, Gjyqtari konfirmues ka mbajtur një seancë konfirmuese në lidhje me akuzat e bashkuara.
23. Më 31 janar 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë mori një vendim për pranueshmërinë e provave, duke vendosur se disa nga provat e konfiskuara janë bërë në kundërshtim me ligjin dhe të drejtat e parashtruesit (PPS. nr. 02/2009).

24. Më 8 shkurt 2011, prokurori paraqiti ankesë kundër këtij vendimi në kolegjin prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Përveç kësaj, më 22 shkurt 2011, parashtruesi paraqiti një përgjigje ndaj ankesës së prokurorit.
25. Më 1 mars 2011, kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë pranoi ankesën e prokurorit dhe anuloi vendimin e 31 janarit 2010, me arsyetimin se “nuk është e mundur që gjyqtari gjatë seancës për konfirmim të aktakuzës që të shqyrtojë provat e gjalla, ose, sipas mendimit të trupit gjykues, të bëjë vërtetimin përfundimtar të fakteve që kanë quar në mbledhjen e provave. Kjo është kompetencë ekskluzive e trupit gjykues”. Prandaj, rasti iu kthye Gjyqtarit konfirmues për të lëshuar një vendim mbi padinë vetëm në pajtim me nenin 316 të KPK (PPS. nr. 02/2009, P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10).
26. Më 2 mars 2011, Gjyqtari konfirmues konfirmoi pjesërisht padinë kundër parashtruesit (KA 278/10, KA 309/10, P 340/10).
27. Prokuroi bëri ankesë kundër këtij vendimi tek kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi, po ashtu, paraqiti një përgjigje ndaj ankesës së prokurorit.
28. Më 27 prill 2011, kolegji prej tre gjyqtarëve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë pranoi ankesën e prokurorit dhe modifikoi vendimin e Gjyqtarit konfirmues të 2 marsit 2011 dhe me këtë u konfirmuan të gjitha akuzat (P. nr. 309/10, P. nr. 340/10, KA. nr. 278/10 dhe KA. nr. 309/10).

Pretendimet e parashtruesit

29. Parashtruesi pretendon si në vijim:

(i) Shkelja e të drejtës për seancë të drejtë dhe të paanshme

- a. Parashtruesi asnjëherë nuk ka qenë i informuar për vendimin e Gjykatës për vazhdimin e hetimeve dhe ky vendim nuk i është dorëzuar atij asnjëherë. Prandaj, parashtruesi nuk mund të paraqesë ose të ankohet në këtë vendim qartazi të padrejtë dhe joligjor (në vazhdimin e hetimeve). Prandaj, atij i është mohuar e drejta për seancë të hapur dëgjimore;
- b. Parashtruesi pohon se, hetimi vazhdon për dy vjet pa iu dhënë mundësia për një seancë të hapur dëgjimore. Prandaj, i ishte mohuar edhe mundësia për një seancë të hapur dëgjimore të drejtë dhe të paanshme për padinë penale brenda një kohe të arsyeshme...;
- c. Parashtruesi nuk ishte i informuar lidhur me vendimin mbi vazhdimin e hetimeve. Prandaj, atij i ishte mohuar seanca e hapur dëgjimore e paanshme për padinë penale.

(ii) Shkelja e parimeve të barazisë së armëve

Parashtruesi pohon se një “kontroll” i paparalajmëruar ishte kryer në klinikën Medicus dhe atij nuk i është dhënë ndonjë regjistër i inventarit të “kontrollit”. Më tej, ai pohon se më 31 janar 2011, Gjyqtari konfirmues [...] mori një vendim për tërheqjen e provave të konfiskuara [...]. Rrjedhimisht, prokurori ka paraqitur një ankesë të fshehur kundër vendimit të Gjyqtarit konfirmues. Mbrojtjes asnjëherë nuk i është dorëzuar kjo ankesë. Prokurori, në shenjë mirësjelljeje, informoi parashtruesin për ankesën. Avokati i paraqiti një përgjigje kolegjit ankimor [...]. Prandaj, atij i ishte mohuar barazia e armëve dhe e drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

(iii) Shkelja e të drejtës për proces të rregullt

- d. Parashtruesi pohon se më 2 mars 2011, Gjyqtari konfirmues lëshoi një vendim që konfirmon akuzën kundër tij [...]. [...] Prokurori paraqiti një ankesë të fshehtë kundër vendimit të Gjyqtarit konfirmues. Mbrojtjes asnjëherë nuk i është dorëzuar as kjo ankesë. Prokurori prapë informoi të përmendurit lidhur me faktin e kësaj ankese. Avokati paraqiti një përgjigje në kolegjin ankimor [...]. Prandaj, atij i është mohuar procesi i rregullt themelor për akuzat penale.
30. Me pak fjalë, parashtruesi pretendon kryesisht shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe shkelje të procesit të rregullt ligjor.
31. Të gjitha shkeljet dyshohet se kanë ndodhur gjatë hetimeve, në fazën e procedurës paraprake të procedurave penale që janë ende në pritje.
32. Pothuajse të gjitha vendimet e kontestuara ishin temë e ankesës, ku është vendosur se “çështja e pranueshmërisë së provave duhet të përcaktohet si duhet nga Kolegji shqyrtues”.
33. Parashtruesi i bazon pretendimet e tij kryesisht në nenin 6 [E drejta për gjykim të drejtë] dhe nenin 5 [E drejta për liri dhe siguri] të KEDNJ.
34. Neni 5 (4) dhe neni 6 (1) i KEDNJ ndjekin qëllime të ndryshme [E drejta për liri dhe siguri; e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm]. Rrjedhimisht, kreu penal i nenit 6 nuk zbatohet në procedurat për shqyrtimin e ligjshmërisë së paraburgimit, që bie në sferën e nenit 5 (4), i cili është *lex specialis* në lidhje me nenin 6 (shih *Reinprecht v. Austria*, §§ 36, 39, 48 dhe 55).
35. Në përgjithësi, neni 5 ka të bëjë me të drejtën për t’u informuar lidhur me akuzat, ndërkaq neni 6 ka të bëjë me të drejtën për të kontestuar dhe diskutuar akuzat.
36. Varësisht nga Gjyqtari i rastit, dhe nëse është e nevojshme edhe nga shqyrtimi kryesor, për të konsideruar shkeljet e pretenduara dhe për të përcaktuar lidhur me akuzat penale, Trupi gjykues duhet të zbatojë Kodin e Procedurës Penale në mënyrë konsistente me Kushtetutën dhe me Konventën Evropiane të jurisprudencës.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

37. Gjykata thekson se mund të vendosë për pranueshmërinë e kërkesës, vetëm nëse parashtruesi tregon se ai/ajo ka shteruar të gjitha mjetet efektive juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 113.7 i Kushtetutës përcakton se “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Në anën tjetër, neni 47,2 i Ligjit përcakton se “*Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj*”.

38. Parimi ndihmës kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt në mënyrë që të parandalojë shkeljen e kushtetutës ose, nëse ndodhë, të korrigojë një shkelje të atillë të të drejtës themelore.

39. Arsyeja për vendimin e shterimit është që t'u ofrojë autoriteteve përkatëse, përfshirë edhe gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Vendimi bazohet në supozimin se rendi ligjor i Kosovës do të ofrojë një mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i karakterit ndihmës të Kushtetutës (shih Aktvendimi mbi pranueshmërinë: AAB-RIINVEST University L.L.C., i Prishtinës kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09 i 21 janarit 2010, dhe shih *mutatis mutandis*, KEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
40. Në fakt, si rregull i përgjithshëm, Gjykata Kushtetuese do të intervenojë vetëm kur bëhen shkelje në interpretimin e Kushtetutës ose kur ligjet nuk përputhen me Kushtetutën, por vetëm pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj.
41. Në rastin në fjalë, Gjykata vëren se rasti është ende në pritje para gjykatës së rregullt, ku parashtruesi do të jetë ende në gjendje të ngrejë ankesat e tij para gjyqtarit i rastit, lidhur me shkeljen e pretenduar të të drejtave të tij gjatë periudhës së procedurës paraprake. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk ka ende vendim përfundimtar për t'u kontestuar në Gjykatë.
42. Prandaj, parashtruesi nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, përfshirë edhe instancën e fundit, sipas ligjit në fuqi, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit.
43. Për sa u tha më sipër, kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

